



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KOMUNA E KAMENICËS
Zyra e Kryetarit
Nr.02/dt.14/11/2024
Kamenicë.

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



THIRRJE

Për..... nga.....

Kryetari i Komunës, konform dispozitave në fuqi të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, caktoi mbledhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi e cila do të mbahet më **21/11/2024**, më fillim në ora **14.00h**.

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Paraqitja e gjendjes aktuale në komunë. Raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Kamenicë;
3. Sanimi i rrugëve-probleme me infrastrukturës rrugore në disa pjesë me (dëmtime, gropa në rrugët e qytetit dhe fshatrave) si dhe ndriçimi publik ;
4. Funksionimi i kamerave në qytet;
5. Të ndryshme

Mbledhja do të mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal në Ndërtesën e Administratës Komunale në Kamenicë.

Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

I përpiluar më datë 20/06/2024, me fillim në ora 14:00, në sallën e Kuvendit Komunal në Kamenicë. Prezent janë Kryetari i Komunës z. Kadri Rahimaj me anëtarë të KKSB-së dhe përfaqësues të KFOR-it, e OSCE .

Rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Paraqitja e gjendjes aktuale në komunë. Raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Kamenicë;
3. Fatkeqësitë natyrore, vërshimet, erërat e forta, bllokimi i kanaleve dhe;
4. Mirëmbajtja e gjelbërimit;
5. Të ndryshme

Mbledhjen e hapi dhe udhëhoqi z. Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës i cili përshëndeti të pranishmit dhe hodhi në votim rendit e ditës, ku rendi i ditës miratohet nga të gjithë të pranishmit.

Pika I

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës; hedhë në votim procesverbalin i cili miratohet nga të pranishmit në takim.

Pika II

Paraqitja e gjendjes aktuale në komunë. Raport për gjendjen e sigurisë në Komunën e Kamenicë.

Florim Klaiqi, Komandant i Stacionit Policor Kamenicë; ne takimin e fundit të KKSB-së kam paraqit gjendjen e sigurisë e cila është e qete ,nuk ka raste që e cenojnë sigurinë e përgjithshme shqetësuese mbete siguria ne trafikun rrugor.

Po japi edhe statistikat e 6 mujorit të parë Janar-Qershor 2024 deri në këtë datë 20.06.2024:

Raste gjithsejtë janë:111 prej tyre ;

Vepra penale:92;

Kundër pasurisë janë:30;

Dhune në familje janë:13;

Kundër jetës dhe trupit:28, këto janë veprat penale me kryesoret prej tyre janë të mbyllura 75% dhe 25% janë nën hetime;

Incidente :19 ;

Aksidente me dëme materiale janë: 15;

Tiketa të shqiptuara deri në këtë fazë janë:3000;

Këto janë statistikat për 6 mujorin e parë të vitit 2024;

Sherefedin Vranaja përfaqësues i OJQ-ve; shpreh një shqetësim qe policia gjatë patrullimit në rrugë nuk veshin jelek sinjalizues të sigurisë.

Florim Klaiqi, Komandant i Stacionit Policor Kamenicë, vërejtja është me vende dhe do të rregullohet kjo çeshtje.

Pika III

Fatkeqësitë natyrore, vërshimet, erërat e forta, bllokimi i kanaleve;

Kujtim Kallaba, drejtor sa i përket gjendjes së vërshimeve komuna jonë është e rrezikuar nga disa përrenj te rrëmbushem si përroi i kulluarve dhe disa ura janë të rrezikuara ndërsa disa kanale paraqesin rrezik në Koretin po edhe ato së shpejti do te zgjidhen.

Naser Vllasi nga DMSH-ja; deklaron ujëmbledhëseve, ujëlëshuesve, kanaleve të hapura atmosferike, dhe si shqetësim kryesor mbyllja e kanaleve atmosferike nga pronarët e tokave si në rrugët regjionale po ashtu dhe në lokale pa kritere, pa leje e ku ish dashur të mirën lejet nga organi kompetent për kyçje në rrugë ne të kundërtën të ketë dënime të parapara me rregullore në nivel lokal për tërë territorin e komunës së Kamenicës, tu pas parasysh dëmet që i shkaktohen rrugëve me veprime të tilla. Ku si pasojë kryesore sipas meje janë projektet e bëra që nga pas lufta nga ana e drejtorisë për urbanizëm ku vazhdojnë të njëjtat dukuri negative dhe me zyrën e projekteve, qe do thotë projekte në numër e jo ne cilësi dhe ulje te rreziqeve të mundshme siç ballafaqohemi me vërshimet në të gjitha rrugët po thuaj se, falënderimi për fjalën dhe pjesëmarrjen time shkon për Kryetarin Z. Kadri Rahimaj në fund.

Pika IV

Mirëmbajtja e gjelbërimit


Hysen Jerliu, Udhëheqës për Mbeturina, kemi një buxhet prej 80000 dhe mirëmbajtje prej 83243 me tra katrorë ku mirëmbahet vazhdimisht, shpejtë mirëmbajtja besohet ti kalohet NPK-së ,ku mirëmbahet vazhdimisht sfidë mbetet hedhja e mbeturinave te ngurta sidomos afër Krileva kompani.

Pika V

Të ndryshme

Hyrmete Morina Përfaqësues i Komuniteti i Personave me aftësi të Kufizuara, një shqetësim rrethe nderimit të qasjen në objektin e shtëpinë e kulturës për personat me aftësi të kufizuar dhe punimet rrethe saj, shqetësim tjetër mbetet ndërtimi i një objekti per nevoja te Handikosit, posi qe objekti ekzistues është shumë i vjetër.

Procesmbajtës:


Fisnik Kastrioti

Kryetari i Komunës


Kadri RAHIMAJ